



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1645/3 prot.

Elbasan, me 29.06.2023

VENDIM

Nr. 24, datë 29.06.2023

**Për
miratimin e marrjes së mjediseve mësimore me Qira**

Në mbështetje të Ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së nr 469 datë 03.06.2015 " Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Marrjen me qira të mjedise me sipërfaqe 900-1000 m² për qëllime mësimore për Departamentin edukim fizik e sporte në Fakultetin e shkencave të edukimit. Mjediset të jenë salla me sipërfaqe: dy mjedise me sipërfaqe 60-70 m² secili, një mjedis me sipërfaqe 100 m² dhe pjesa tjetër mjedise me sipërfaqe jo më e vogël se 150 m² secila, të përshtatshme për instalimin e pajisjeve sportive për kryerjen e procesit mësimor të sportit.
2. Afati i marrjes me qira i objektit të jetë jo më pak se 5 vite.
3. Fondi limit në dispozicion të jetë 2,716,200 lekë në vit ose 226,350 lekë në muaj.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi